



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë 22.09.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 18.09.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "AC ING SHPK & AAG PROJEKT shpk" për aktivitetin: "Ndertimi i Qendres te Mjekesise Familjare ne Veternik" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-1234-511 nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "AC ING SHPK & AAG PROJEKT shpk" e datës 18.09.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndertimi i Qendres te Mjekesise Familjare ne Veternik" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-1234-511.

Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj tutje me *kete aktivitet*.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "AC ING SHPK & AAG PROJEKT shpk" me datë 18.09.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndertimi i Qendres te Mjekesise Familjare ne Veternik" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-1234-511. Autoriteti Kontraktues, me datë 21.09.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e OE-ik "AC ING SHPK & AAG PROJEKT shpk" lidhur me aktivitetin e prokurimit: Ndertimi i Qendres te Mjekesise Familjare ne Veternik" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-1234-511.

-Pretendimi juaj lidhur me lidhshmërinë e pozicioneve të armaturës dhe betonit është plotësisht i pa bazuar, pasi që të gjitha pozicionet janë paraqitur ndaras dhe poashtu edhe çmimet janë ndaras;

-Pretendimi për ndryshimin e çmimit me më shumë se 2% të tenderuesit i propozuar për kontratë nuk është trajtuar si bazë për eliminim, sepse jo vetëm të ky tenderues, por edhe të shumica e tenderueseve tjerë është paraqitur ky ndryshim si rezultat i gabimeve në formulën e përshkrimit të çmimit e jo me fajin e tyre;

-Pretendimet se autoritetet tjera kanë refuzuar tender për arsye të tilla është e pa bazuar pasi që edhe nëse ka ndodhur është plotësisht e pa drejtë që të refuzohen për gabimet e Autoriteteit Kontraktues;

-Lidhur me pretendimet për stafin ju sqarojmë se grupi i |OE-ik të propozuar për kontratë i plotëson të gjitha kërkesat nga FDT-ja e dosjes së tenderit;

-Lidhur me bazën e betonit ju njoftojmë se sipas nenit 72 të LPP-së është kërkuar sqarim dhe është verifikuar se i ka të gjitha dëshmitë e kërkuara.

Bazuar në sqarimet paraprake u vendos si në Dispozitiv të Vendimit.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit